



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12, të Ligjit Nr. 06/L- 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, në mbledhjen e 218-të, të mbajtur me datë 27 maj 2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), për monitorimin e procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve për Departamentin Special, në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 maj 2019.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 23 prill 2019, ka shpallur konkurs të brendshëm për pesëmbëdhjetë (15) pozita të lira për gjyqtarë, të cilët do të ushtrjnë funksionin e tyre në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.

Me datë 8 maj 2019, KGJK ka pranuar një shkresë nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), përmes së cilës kërkohet të monitorohet procesi i përzgjedhjes së gjyqtarëve për Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.

KGJK, në takimin e mbajtur me date 27 maj 2019, pasi që shqyrtoi kërkesën përkatëse, konsideroi se nuk ka bazë ligjore.

Andaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në mungesë të memorandumit të bashkëpunimit në mes të KGJK-së dhe GLPS-së, ku do të specifikoheshin të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, posaçërisht mbrojtja e të dhënave personale të kandidatëve, vlerësoi se kërkesa duhet të refuzohet.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Skënder ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS);
- Arkivit.